

# Elastovill E-KV-4S

Membranë hidroizoluese, me përbërje poliestre të patretshme, me shtresa bituminoze elastomeri

## PËRSHKRIMI I PRODUKTIT


Elastovill E-KV-4 S është një membranë hidroizoluese, e përbërë nga 250 gr fije poliestre të patretshme, me shtresa bituminoze elastomeri nga të dyja anët. Ana e sipërme është e veshur me kokrriza rëre, të cilat përshtaten lehtësisht me lëndën djegëse për një ngjitje të shpejtë. Proçesi i prodhimit dhe kontrolli i cilësisë së tij, janë të çertifikuara sipas standardit EN ISO 9001.

## KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

Elastovill E-KV-4S falë elasticitetit të saj në temperaturë të ulët, ajo ofron mundësi shumë të mira përpunimi dhe aplikimi, si edhe ofron fleksibilitet dhe aftësinë për tu kthyer në gjendjen e saj fillestare edhe në temperatura të ulta. Një strukturë e plotë dhe elastike tregon qëndrueshmëri të shkëlqyer në rast riparimesh mekanike. Falë qëndrueshmërisë së kokrrizave të rërës në sipërfaqe, ndaj ndikimeve të jashtme, nuk kërkohen masa shtesë për mbrojtjen e sipërfaqes.

## APLIKIMI

Elastovill E-KV-4 S përdoret si shtresë hidroizoluese e sipërme në sistemin hidroizolues disashtresor sipas EN 13707 dhe për këtë arsye përdoret si në ndërtime të reja, ashtu edhe në riparimin e çatave të rrafshta e të pjerrta, në ndërtimet nëntokësore, shtëpitë shumëkatëshe dhe në objektet industriale. Kjo membranë hidroizoluese rekomandohet në mënyrë të veçantë sidomos kur pritet një zhvendosje e madhe termike e nëntokës (konstruksione çatie të lehta, ngarkesa termike, beton i paizoluar dhe i dobësuar, nyje, çarje etj.) Ngjitja bëhet kryesisht me flakë të nxehtë, në mënyrë të barabartë në të gjithë sipërfaqen.



## TË DHËNA TEKNIKE

Trashësia	afërsisht 4,2 mm
Masa e sipërfaqes	afërsisht 4,6 kg/m <sup>2</sup>
Forca e tërheqjes (për së gjati/tërthorazi)	≥ 700 N/5 cm / ≥ 700 N/5 cm
Elasticiteti ndaj tërheqjes (për së gjati/tërthorazi)	≥ 30% / ≥ 30%
Fleksibiliteti në temperaturë të ulët	- 15 °C
Rezistenca ndaj nxehtësisë	+ 100 °C
Papërshkueshmëria nga uji, në 24 orë	400 kPa
Shtresëzimi	Fibra poliestre
Rezistenca ndaj zjarrit nga jashtë	Klasi F
Reagimi ndaj zjarrit	Klasi E
Rezistenca ndaj ngarkesës statike	20 kg
Rezistenca ndaj kimikateve	ujit, tretësirave të kripës, tretësirave të holluara dhe kaustike
-	
Rezistente ndaj	
Rezistenca ndaj kimikateve	vajit, produkteve të naftës dhe tretësirave të hidrokarbureve
- Jo rezistente ndaj	
Përmasat e rulonit, Gjatësia/Gjerësia	10,0 m / 1,0 m
Numri i produktit	100706
Testuar sipas standarteve të BE-së	

Vlerat e dhëna janë nominale dhe subjekt i variacioneve statistikore. I nënshtrohen ndryshimeve teknike. Është detyrim i përdoruesit për të vlerësuar përputhshmërinë e specifikimeve të produktit dhe të sigurohet që ka një version të vlefshëm të fletës së të dhënave teknike.

Elastovill E-KV-4S

Botimi: Mars 2015

## MAGAZINIMI

Elastovill E-KV-4S duhet të vendoset vertikalisht dhe të ruhet nga lagështia, rrezet UV dhe temperaturat e larta. Në kushte atmosferike të ftohta, produkti duhet të qëndrojë në magazinë të paktën 12 orë pa ngrirë dhe vetëm pak përpara aplikimit, të zhvendoset në kantierin e ndërtimit.



**BMI**

**VILLAS**

BMI Bramac Sisteme për çati Sh.p.k  
Rr. "Ismail Qemali", Pall. 12 katësh (i ri)  
Kati III, Zyra 6  
1001 Tirana, Albania  
[www.bmigroup.com](http://www.bmigroup.com)